



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE E UJËSJELLËS – KANALIZIME FIER SH.A

Nr. _____ prot

Fier, më ____/____/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Materiale KUZ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Tuba Kanalizimesh 44163130-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

2.986.233 (dy million e nentëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e tre), lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), Autoriteti/enti Kontraktor “Shoqëria Rajonale e Ujësjellës-Kanalizime Fier” Sh.A, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

2.1.1 Të jetë qartësisht e specifikuar në QKB, se objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik është i njëjtë ose “ekuivalent” me objektin e prokurimit.

➤ 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, *duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës*.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenet 43 e 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet (2024-2025), të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.25/2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2026 (kestet e maturuara)**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. . Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 KAPACITETI TEKNIK:

Për kapacitetin teknik operatori ekonomik duhet të paraqesë:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme**, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2023-2024-2025) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vlera totale e të cilave duhet të jetë **jo më e vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet**, të realizuar gjatë ketyre tre viteve.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi** dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, **të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara."

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 1/gërma“c” të Ligjit nr.162, dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2 OE ofertues duhet të paraqesë **Autorizim Prodhuesi** ose **distributori zyrtar** për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme pika 2.3.4 është vendosur sipas nenit 40 pika 3, neni 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në nenin 36 pika 3/b) të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit.

2.3.3 Operatori ekonomik, ne momentin e hapjes se ofertave, duhet te paraqese mostra te mallrave qe ofron, qe duhet te permbushin te gjitha specifikimet teknike.Mosdorezimi i mostrave ne momentin e hapjes se ofertave ose mosperputhja e mallrave te ofruara me mostrat e paraqitura, eshte kusht per skualifikim.Mostrat qe duhet te paraqiten jane:

1	Tubo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 160 mm	5 ml
---	--	------

2	Tabo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 200 mm	5 ml
3	Tabo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 250 mm	5 ml
4	Tabo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 315 mm	5 ml
5	Tabo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 400mm	5 ml

Dorëzimi i mostrave, të bëhet pranë Drejtorisë Teknike, të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Fier Sh.A, të mbyllura në një kuti jo transparente, të vulosur mbi të cilin të shënohet: “Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit “**Blerje Materiale Kuz**”.

Data e dorëzimit të mostrave të jetë data e hapjes së ofertave data 24.08.2026, deri në orën 10:00. Mostrat e dorëzuara jashtë këtij afati, nuk do të pranohen nga AK.

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë nr.rendor të Artikullit që përfaqëson. Mos-dorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave ose mospërputhja e mallrave të ofruara me mostrat e paraqitura, është kusht për skualifikim. Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr.Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Arsyetimi: Bazuar në nenin 40 pika 6/gërma(a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Udhëzimin nr.3 datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomik”. Ky kriter vendoset me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë nëse mallrat e ofertuara i plotësojnë specifikimet teknike në DST dhe janë brenda standarteve të kërkuara.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e Cilësisë **ISO 9001:2015** ose (*ekuivalente/ e barazvlefshme me të*) lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Pranohen edhe standardet shqiptare **SSH** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, operatori ekonomik duhet të dorëzojë çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes.)

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas nenit 79 pika 1, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në nenin 44 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter është vendosur ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë me objektin e prokurimit. Çertifikatat duhet të lëshohen nga organet kompetente për të vërtetuar se mallrat i plotësojnë kërkesat e cilësisë, duke mundur realizimin në kohë dhe me cilësi sipas standarteve të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogun e prodhuesit** të mallrave, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara.

Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. **Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.**

Arsyetimi: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike”, për mallrat objekt prokurimi, sipas tabelës të paraqitur nga autoriteti kontraktor në Shtojcën 7. Oferta teknike duhet të plotësohet me saktësi nga ofertuesi për të gjithë artikujt e listës. Në plotësim të kësaj kërkesë dokumenti “Ofertë Teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i produkteve	Emërtimi kompanisë prodhuese.	Emërtimi i katalogut	Referenca në katalogje	Shënime (nëse gjykohet e nevojshme për sqarime nga ofertuesi)
				KOD i produktit ose nr. Faqes në katalog	

• Emërtimi dhe renditja e produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7.

• Emërtimi i Katalogut të prodhuesit/distributorit të autorizuar. Referenca në katalogje, kodi produktit (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr. i faqes), duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ose skedën teknike përkatëse për çdo produkt ku autoritetit kontraktor mund të gjejë specifikimet e plota teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DST.

• Në fushën “SHËNIM” operatori ekonomik ofertues mund të shkruajë sqarime të ndryshme në lidhje me produktet e ofruara.
specifikimet e AK.

Arsyetimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 36 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 40 pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Qëllimi i vendosjes të kriterit të sipërcituar ka të bëjë me faktin e orientimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në fazën e ofertimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira materiale 1 (një) mjet transporti mallrash me kapacitet jo më pak se 1,5 (një presje pese) Ton.

Per mjetin në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm), e) foto e automjetit.

Për mjetin e marre me qira duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm), e) foto e automjetit. Mjetet të shoqërohen me kontratën perkatese të qerash/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.

Per plotesimin e kriterit të mesipër të pikës është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8 (Formulari për mbledhjen e vetedeklarimit). Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përshihen në formularin për mbledhjen të vetedeklarimit, mbajme në konsideratë percaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertes, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në zbatim të ketyre ndryshimeve ligjore operatori ekonomik i kualifikuar i pari në renditje pas mbylljes së fazës së vlerësimit duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues si më poshtë:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihet në dispozicion një mjet transporti me kapacitet mbajtes jo më pak se 1,5 ton, i nevojshëm për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

❖ SPECIFIKIMET TEKNIKE

Tuba të brinjëzuar (korrogato)

Tubacionet e brinjëzuara duhet të jenë të prodhuara prej polietileni me densitet të lartë (PE-HD) dhe të jenë në përputhje me standardin EN 13476, Tipi B, ose ekuivalent.

Tubat duhet të kenë klasë ngurtësie SN8 dhe të jenë të përshtatshëm për përdorim në sisteme kanalizimesh dhe drenazhimi pa presion.

Furnizimi i tubave duhet të bëhet së bashku me të gjithë aksesorët e nevojshëm për bashkim, konkretisht manikotë dhe 2 (dy) guarnicione elastomerike për çdo bashkim, sipas kërkesave të standardit EN 681 ose ekuivalent.

Tubat dhe aksesorët duhet të jenë të rinj, të papërdorur dhe pa dëmtime apo deformime që cenojnë funksionimin e tyre.

Tubot duhet të kenë certifikatë/deklaratë përputhshmërie të produktit me standardin EN 13476, Tipi B, ose ekuivalent, për produktet e ofruara

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162 (i ndryshuar), datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, (e ndryshuar), datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

❖ SASIA dhe GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Tubo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 125 mm	ml	100
2	Tubo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 160 mm	ml	250
3	Tubo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 200 mm	ml	1000
4	Tubo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 250 mm	ml	1200
5	Tubo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 315 mm	ml	800
6	Tubo te brinjezuar me mufte SN8 Ø 400mm	ml	350

❖ **GRAFIKU I LËVRIMIT**

Lëvrimi i mallit të bëhet sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, sipas tabelës së mëposhtme:

Afatet e lëvrimit: **1 muaj nga momenti i nënshkrimit të Kontratës.**

Shënim: këto afate mund të ndryshojnë në varësi të situatave, emergjencave dhe nevojave të punës.

Java	Kërkesa
1-4	Dorëzimi i 100% të sasisë të materialeve të kërkuara, duke u bazuar te preventivi i paraqitur..

NJËSIA E PROKURIMIT

1._____ 2._____ 3._____